

AKT THEMELIMI
ISHOQERISE TREGTARE PRIVATE

"GURI BARDHE" SH.P.K. URA VAJGURORE BERAT

Ne baze te ligjit Nr 7512 dat 10/08/1991 per sanksionimin dhe mbrjtjen e prones private, si dhe ligjit Nr 7638 dat 19/11/1992, per shoqerite tregtare si dhe akteve te tjera ligjore dhe nenligjore, asambleja e ortakeve me vullnet te lire te shprehur me nenshkrimin e ketij akt themelimi nga ortaket: Luan Syri, ~~XXXXXXXX~~ i biri i Isufit i datlindjes 1962, banues ne lagjen 30 vjetori Berat, Bari Paja i biri i Refatit i datlindjes 1954, banues ne lagjen "Jani Vruho" Berat, Tefik Syri i biri i Isufit i datlindjes 1967, banues ne lagjen "Jani Vruho Berat dhe Valbona Syri e bija e Shuaipit e datlindjes 1982, banuse ne lagjen Elirim Berat, me zotesi te plote juradike per te vepruar shpallen si vijon:

Neni 1 Formohet Shoqerija Tregtare Private "Guri i Bardhe" sh.p.k. me seli ne Uren Vajgurore Berat me themelues: 1) Luan Syri i biri i Isufit idatlindjes 1962, banues ne lagjen "30 vjetori" Berat, 2) Bari Paja i biri i Refatit i datlindjes 1954, banues ne lagjen "Jani Vruho" Berat, 3) Tefik Syri i biri i Isufit i datlindjes 1967, banues ne lagjen "Jani Vruho" Berat dhe 4) Valbona Syri e bija e Shuaipit e datlindjes 1982, banuse ne lagjen Elirim Berat.

Neni 2 Shoqerija Tregtare Private "Guri Bardhe" sh.p.k. Ura Vajgurore berat eshte shoqeri me pergjegjesi te kufizuar dhe perballon humbje vetem deri ne kufirin e vleres se kontributit te tyre me kapitalin fillestar.

Neni 3 Shoqerija Tregtare Private "Guri Bardhe" sh.p.k. e ka vend qendrimin e saj ne Uren Vajgurore te Rethit Berat. Ajo mund te hapi dhe vend qendrim te tjera te dyta, dege, filiale, perfaqesi sidhe agjensi operative ne te gjithë teritorin e Shqiperise, me miratim te organeve kopetente edhe jashte vendit.

Neni 4 Shoqerija Tregtare Private "Guri Bardhe" sh.p.k. Ura Vajgurore do ta ket kohezgjatjen e veprimtarise se saje ekonomike me nji afat te pa caktuar e mbi 10 vjet. Ajo mund te shperbehet me vendim te organit me te larte te saje ne 2do kohe dhe per 2do lloj shkak.

Neni 5 Objekti i veprimtarise per Shoqerine Tregtare Private "Guri Bardhe" sh.p.k. Ura Vajgurore Berat do te jete: Prodhimi dhe Tregtimi i materialeve te ndertimit, punime dheu, sistemime, taracime teresh etj, ndertime civile dhe ekonomike, ndertim rruge kat V, IV, veshje me asfaltobeton te rrugeve (ndertim mbishtrese) si dhe sistemim e asfaltim sheshe, ndertim vepra arti rrugore dhe hekurudhore, ndertim ujisjellsh dhe kanalizime, Sillesa, kulla, kullauji etje prej b/arme, rikonstruksione godinash civile e ekonomike, veshje fasadash etje, mirmbajtja dhe zhvillimi i dekorit ne mjedise urbane.

Neni 6 Kapitali fillestar i Shoqerise Tregtare Private "Guri Bardhe" sh.p.k. eshte 100000 lek, i gjitha kapitali i shoqerise zoterohet nga ortaket: Luan Syri, Bari Paja, Tefik Syri dhe Valbona Syri sipas kuotave qe ka investuar secili per blerjen e makinerive e paisjeve dhe krijimin e ketij objekt ne baze te profesverbalit te dates 31/10/2000 dhe inventarit Fizik. firmosur nga ortaket.

Me fillimin e punimeve dhe tregetimi i prodhimeve, ortaket Luan Syri, Bari Paja Tefik Syri e Valbona Syri nuk do te marin pergjande nga fitimi deri sa te shlyhen te gjitha leket qe ka investuar se cili.

Ortaket do ti marin shumat e investuara sipas kuotave per se cilin d.m.th ai qe ka investuar me shume do te mari me i pari deri sa te barazohen shumat e financuara nga te gjithë. Mbasi ti kene mare te gjithë ortaket shumat qe kane financuar, do te marin nga fitimi me pergjande si me posht:

1) Luan Syri do te mari 30% te fitimit Neto, Bari Paja do te mari 30% te fitimit neto, Tefik Syri do te mari 25% te fitimit neto, 4 Valbona syri do te mari 15% te fitimit neto

Bori Paja Luan Syri Tefik Syri Valbona Syri

Neni 7 Kapitali i Shoqerise berbehet nga kapitali fillestar i pershkruar ne nenin 6 mjetet e xhiros, mjetet e punes dhe mjete te tjetra te nevojeshme per ushtrimin e aktivitetit te shoqerise te miratuara me vendim te organeve kopetente te shoqerise tregtare private "Guri Bardhe sh.p.k. Ura Vajgurare Berat, I gjithë kapitali i shoqerise pasqyrohet ne inventar dhe libbret e llogarive.

Neni 8 Organet drejtuesse te shoqerise Tregtare Private "Guri Bardhe" sh.p.k. Ura Vajgurore Berat do te jene:

- 1) Mbledhja e pergjitheshme e themeluseve te shoqefise;
- 2) Kryesija e shoqerise e perbere prej 4 veta.
- 3) Administratori i zgjedhur dhe i miratuar nga mbledhja e pergjitheshme e themeluseve te saje, eshte zoti Luan Syri.
- 4) Komisioni i revizionimit.

Fusha e veprimit, prberja dhe menyra e punes dhe kopetencat e organit drejtues, rregullohen sipas statutit dhe vendimeve qe do te mare organi me i larte i shoqerise tregtare private "Guri Bardhe" sh.p.k. Ura Vajgurore berat.

O R T A K E T


(Luan Syri) (Bari Paja) Tefik Syri) (Valbona Syri)

REPUBLIKA E SHQIPERISE
NOTERI N. Dreni BERAT

Nr. 3977/1040

V E R T E T I M

Sot me daten 23. 11. 2000 para meje noterit N. Dreni u paraqiten personalisht palet kontratuese: 1) Luan Syri i biri i Isufit i datlindjes 1962, banues ne lagjen "30 vjetori" Berat me pasaporte Nr 58121 2) Bari Paja i biri i Refatit idatlindjes 1954, banues ne lagjen "Jani Vruho Berat me ~~pasaport~~ pasaport Nr 12/32 3) Tefik Syri i biri i Isufit i datlindjes 1967, banues ne lagjen "Jani Vruho Berat me pasaporte Nr 4/41 4) Valbona syri e bija e Shuaipit e datlindjes 1982, banuse ne lagjen Elirim Berat mr pasaporte Nr 20/10; Te pa njohur prej meje dhe te identifikuar me dokumentin e tyre personal, me zotesi te plote juridike per te vepruar, dhe me vullnetin e tyre te lire, neneshkruan para meje dokumentin e me siperm.



NOTERI

(Natura Dreni)

S T A T U T

I Shoqerise Tregtare Private "Guri Bardhe"
SH.P.K? Ura Vajgurore Berat

Ne baze te ligjit Nr. 512 dat 10/8/1991 per sanksionimin dhe mbrojtjen e pronave private, te nismes se lire te veprimtarise private te pa mvarur dhe privatizuar si dhe ligjit Nr. 7638 dat 19/11/1992 per shoqerite Tregtare si dhe akteve te tjera ligjore dhe nenligjore. Asambleja e ortakeve me vullnet te lire, te shprehur me nenshkrimin e aktit te Themelimit qe i bashkangjitet ketij statuti duke e shprehur kete vullnet me formen e kerkuar kerkuar nga ligja dhe nepermjet administratoreve te saje Z. Luan Syri i biri i Isufit i datlindjes 1962, banues ne lagjen " 30 vjetori" Berat, Z. Bari Paja i biri i Refatit i datlindjes 1954, banues ne lagjen "Jani Vruho" Berat, Z. Tefik Syri i biri i Isufit i datlindjes 1967, banues ne lagjen "Jani Vruho" Berat, Z. Valbona Syri e bija e Shuaipit e datlindjes 1982 banuese ne lagjen "Elirimi" Berat, me zotesi te plote juridike per te vepruar, shpallen si vijon:

FORMIMI I SHOQERISE

Neni 1 Formohet shoqerija Tregtare private e emertuar " Guri i Bardhe" SH.P.K. Ura Vajgurore Berat me themelues: 1) Luan Syri i biri i Isufit, i datlindjes 1962 banues ne lagjen "~~XXXXXXXXXXXX~~, qe 30 vjetori" Berat, 2) Bari Paja i biri i Refatit i datlindjes 1954, banues ne lagjen " Jani-Vruho" Berat, 3 Tefik Syri i biri i Isufit i datlindjes 1967, banues ne lagjen "Jani Vruho" Berat, 4 Valbona Syri e bija e Shuaipit, e datlindjes 1982, banuese ne lagjen "Elirim" Berat.

F O R M A

Neni 2 Shoqerija Tregtare Private "Guri i Bardhe" SH.P.K. Ura Vajgurore Berat eshte shoqeri me pergjegjesi te kufizuar dhe perballon humbjet vetem deri ne kufirin e vleres se kontributit te tyre ne kapitalin fillestar.

VEND QENDRIMI I SHOQERISE

Neni 3 Shoqerija Tregtare Private "Guri i Bardhe" Sh.P.K. Ura Vajgurore Berat e ka vendqendrimin e saje ne Uren Vajgurore Berat, Shoqerija mund te hapi dhe vend qendrim te tjera te dyta, Dege, filiale, perfaqesi si dhe agjensi operative ne te gjithë teritorin e Shqiperise dhe me miratim te organeve kopetente edhe jasht vendit.

KOHEZGJATJA E SHOQERISE

Neni 4 Shoqerija Tregtare Private "Guri i Bardhe" SH.P.K. Ura Vajgurore Berat do te kete kohezgjatjen e veprimtarise se saje ekonomike per nji afat te pa caktuar e mbi 10 vjet. Ajo mund te shperbehet me vendim te organit me te larte saje ne keto kohe e per keto lloj shkak.

OBJEKTI I VEPRIMTARISE

Neni 5 Objekti veprimtarise i Shoqerise Tregtare Private "Guri Bardhe" SH.P.K. Ura Vajgurore Berat do te jete: Prodhim dhe tregtim i materialeve te ndertimit, Punime dhu, sistemime, taracime terenesh, ndertime civile dhe ekonomike, ndertime RRuge kat; V, IV, veshje me asfaltobeton te asfite

Bori Paja
Luan Syri

Tefik Syri

Valbona Syri

(ndertim mbi shtrese) si dhe sistemim e asfaltim sheshë, ndertim vepra arti rrugore dhe hekurudhere, ndertim ujisjellea dhe kanalizime, Sillosa, Kallë, ujë ujë prej b/arme, rikonstruksione godinash civile e ekonomike, veshje fasadash etj, mirmbajtja dhe zhvillimi dekorit ne mjedise urbane.

KAPITALI I SHOQERISE

Neni 6 Kapitali fillestar & shoqerise Tregtare private "Guri Bardhe" SH.P.K. Ura Vajgurore Berat eshte 100000 lek. I gjithe kapitali i shoqerise zoterohet nga ortakët Luan Syri, Bari Paja, Tefik Syri e Valbona Syri sipas kuotave qe ka investuar se cili per blerjen e makinerive e paisjeve dhe krijimin e ketij objektine baze te proces verbalit te dates 31/10/2000 firmosur nga ortakët.

Me fillimin e punimeve dhe tregëtimi i prodhimit te materialeve, ortakët Luan Syri, Bari Paja Tefik Syri e Valbona Syri nuk do te marri perqindje nga fitimi deri sa te shlyhen leket qe ka investuar se cili.

Ortakët do ti marri shumat e investuara sipas kuotave per se cilin d; m ai qe ka investuar me shume do te marri me i pari deri sa te barazohen shumat e financuara nga te gjithë.

Mbasi ti kene mare te gjithë ortakët shumat e investuara, do te fillojne te marri nga fitimi me perqindje si me poshte:

1) Luan Syri do te marri 30% te fitimit neto, 2) Bari Paja do te marri 30% te fitimit neto, Tefik Syri do te marri 25% te fitimit neto dhe Valbona Syri do te marri 15% te fitimit neto.

Neni 7 Kapitali i shoqerise perbehet nga kapitali fillestar i pershkruar ne nenin 6, mjetet e xhires dhe mjete te tjera te nevojeshme per ushtrimin e aktivitetit te shoqerise te caktuara nga vete shoqerija tregtare private "Guri Bardhe" Ura Vajgurore Berat, i gjithe kapitali i shoqerise regjistruhet ne inventar dhe ne librat e llogarive.

Neni 8 Fitimet qe do te realizohen gjate veprimtarise ekonomike ege konkretizohen me nxierjen e bilanceve periodike, u ndahen ortakeve te shoqerise me perqindjen e pershkruar ne nenin 6 por kurdohere mbasi te jene shlyer detyrimet ligjore, secili prej antareve te shoqerise Tregtare Private "Guri Bardhe" SH.P.K. Ura Vajgurore Berat eshte perdorues dhe disponues i pjese te pronesise perkatesisht i makinerive ne pronesi te se cilit kdo antar mund te shesi kuoten e tije por bleresi nuk mund te behet antar i shoqerise pa dhene pelqimin kryesija e shoqerise.

Neni 9 Shoqerija Tregtare Private "Guri Bardhe" SH.P.K. Ura Vajgurore Berat mer persiper te drejta e detyrime vetem brenda kapitalit te saje. Themeluesit mbartin rrezikun e veprimtarise se shoqerise, secili prej tyre ne nivelin e kapitalit te investuar ne te, po keshtu edhe shoqerija brenda kufirit te kapitalit te pergjitheshem te themelueseve te saje.

ORGANET DREJTUESE TE SHOQERISE

Neni 10 Organet drejtuese te shoqerise Tregtare Private "Guri Bardhe" SH.P.K. Ura Vajgurore Berat do te jete: 1) Mbledja e pergjitheshme e themelueseve te shoqerise, 2) Administratori i Shoqerise, 3) Komisioni i revizionimit.

Fusha e veprimit, perberja dhe menyra e punes dhe kopetencat e organit drejtues rregullohen sipas ketij statuti dhe vendimeve qe do te marri organi me i larte i shoqerise. Administrator i shoqerise eshte z. Luan Syri

Neni 11 Shoqerija Tregtare Private "Guri Bardhe" SH.P.K. Ura Vajgurore Berat Deklarohet e krijuar ne zbatim te plote te legjislaclonit shqiptar ne fuqi brenda normave qe permban ky statut dhe akti i themelimit te shoqerise.

Shoqerija Tregtare Private "Guri Bardhe" SH.P.K; Ura Vajgurore Berat fiton zotesine e saje te plote per te vepruar me regjistrimin e saje ne gjykate dhe ne regjistrin e organit perkates Tatimor.

Bari Paja Luan Syri Tefik Syri Valbona Syri

Neni 12 Shoqëria ka vulen e sajë me përmbajtjen Shoqëria Tregëtare Private "Guri Bardhe" SH.P.K. Ura Vajgurore Berat.

Neni 13 Organi më i lartë është mbledhja e përgjithshme e themeluseve e cila më vendime kur janë të pranishëm jo më pak se 2/3 e themeluseve. Vendimet meren me votim të hapur dhe me shumicë votash, mbledhja e përgjithshme e themeluseve të shoqërisë thirret jo më rrallë se 2 herë në vit.

Neni 14 Mbledhja e përgjithshme e ~~SHOQËRISË~~ themeluseve të shoqërisë tregëtare Private "Guri Bardhe" SH.P.K. Ura Vajgurore Berat ka këto të drejta e detyrime: -Miratoni statutin e shoqërisë Tregëtare Private.

- Miratoni programin për zhvillimin e veprimtarisë së shoqërisë.
- Cakton kompetencat e kryesisë dhe administratorit të shoqërisë
- Ka të drejtë të pranojë dhe të përjashtojë antarët e shoqërisë dhe të gjitha të drejtat e tjera që kanë organet më të ulëta të shoqërisë.

-Shqyrton vendimet e organeve më të ulëta mbi bazën e ankimit dhe kërkesës së antareve.

Mbledhja e përgjithshme e themeluseve të shoqërisë thirret nga kryesia e shoqërisë dhe në rast të jashtëzakonshme edhe nga grup themelues që përbejnë jo më pak se 1/4 e antareve të shoqërisë.

Neni 15 Kryesia e shoqërisë përbëhet prej 4 veta dhe zgjidhet nga mbledhja e përgjithshme e themeluseve të shoqërisë 1 herë në 2 vjet. Kryesia mbledhet 1 herë në muaj në mbledhje të zakonshme dhe ka këto kompetenca:

- 1) Miratoni programin për zhvillimin e aktivitetit të shoqërisë, cakton fëmijët e transportit për të gjitha llojet e mallrave.
- 2) Miratoni fondet që duhet të krijohen dhe kontributin që dhëhet të derdhet secili antar në përputhje me makineritë që kanë në pronësi.

3) Miratoni numurin e punonjësve që mund të marrë në punë të përherëshme ose të përkohëshme.

4) Miratoni krijimin e ortakëve ose marrveshjeve të ndryshme me persona fizik apo juridik, vendas ose të huaj.

5) Miratoni pagat për punonjësit e sajë në vartësi të vendeve të punës

6) Propozon nga gjiri i sajë administratorin që zgjidhet nga mbledhja e përgjithshme e themeluseve, kontrollon veprimtarinë e administratorit dhe ndjek shlyerjen e detyrimeve ndaj shtetit.

7) I propozon mbledhjes së përgjithshme të themeluseve për ndihmën që duhet të jepet nga fondet e shoqërisë ndonjë antari të shoqërisë që demtohet apo aksidentohet.

Neni 16 Administratori i shoqërisë zgjidhet 1 do vit nga mbledhja e përgjithshme e dhe është antar i kryesisë, ai ka këto të drejta dhe detyrime:

1) Organizon, drejton dhe kontrollon veprimtarinë e kolektivit të themeluseve të shoqërisë dhe raporton në organet më të larta të shoqërisë.

2) I propozon mbledhjes së përgjithshme të themeluseve të shoqërisë programin ekonomik-financiar dhe realizon venien më jete të tijë.

3) Përfaqeson shoqërinë në gjykatë, në organet e zgjidhjeve të konflikteve në marrëdhëniet më të tretet dhe ka të drejtë të autorizojë me prokurë të posaçme persona të tjere për të përfaqësuar shoqërinë.

4) Nënshkruan marrveshje dhe kontrata në emër të shoqërisë dhe siguron zbatimin e tyre.

5) Më në punë punonjës me kontratë, më ose pa afat brenda numurit të caktuar nga kryesia e shoqërisë.

6) Përgjigjet dhe jep llogari para kryesisë së shoqërisë dhe mbledhjes së përgjithshme të themeluseve të sajë për veprimtari ekonomike e financiare të shoqërisë. 7) U jep zgjidhje të gjitha çështjeve që nuk janë në kompetencë të kryesisë dhe mbledhjes së përgjithshme të themeluseve të shoqërisë

Neni 17 Shoqëria Tregëtare Private "Guri Bardhe" SH.P.K. Ura Vajgurore Berat nuk përgjigjet më pasurinë e sajë për detyrimet e themeluseve dhe as themeluesit nuk përgjigjet për detyrimet e shoqërisë më pasurinë e tyre.

Bora Gajse

Lumë

Refik Syri

Valbona Syri

V.Syr

Neni 18

Te gjitha mosmarrveshjet qe do te lindin midis shoqerise dhe personave te treta, midis antareve dhe shoqerisedhe qe nuk jane rregulluar me kontrate ose marrveshje te vefante do te zgjidhen sipas legjislacionit ne fuqi te Republikes se Shqiperise.

Neni 19

Themeluesit e shoqerise dhe punonjesit qe punojne ne te, per mos marrveshjet qe mund te lindin ndermjet tyre dhe organeve te shoqerise me perjashtim nga kolektivadhe largim nga puna kane te drejte te ankohen ne gjykatën e rethit brenda 10 diteve nga dita e komonikimit te vendimit.

Neni 20

Shoqerija Tregtare Private "Guri Bardhe" SH.P.K. Ura Vajgurore Berat do te pusgoje veprimtarine e sajë vetem me vendim te mbledhjes se prgjithshme te themeluseve te shoqerise pasi te kete bere te gjitha likuidimet e ndaj shtetit, ndaj te tretteve dhe personave qe kane mare ne pune. Per detyrimet ndaj te tretteve secili prej themeluseve pergjigjet brenda pjeses se kapitalit te tijë.

Neni 21

Ky statut u hartua dhe u miratua nga mbledhja e pergjitheshme e themeluseve te shoqerise ~~XXXXXX~~ Tregtare Private "Guri Bardhe SH.P.K. Ura ~~XXX~~ Vajgurore Berat sot me datën _____ dhe hyn ne fuqi nga dita e regjistrimit ne gjykatën e Rethit Tirane dhe ne organet tatimore perkatese

O R T A K E T


(Luan Syri) (Bari Paja) (Tefik Syri) (Valbona Syri)

[Handwritten signatures of Luan Syri, Bari Paja, Tefik Syri, and Valbona Syri]

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
NOTERE NATASHA DERVISHI BERAT
Nr. 3976. Rep. Nr: 1039. Kol.

V E R T E T I M

Sot, më 23.11. 2000, para meje noteres Natasha Dervishi ne Berat, u paraqitën personalisht palet kontraktuese: - - - - -
1. Luan Syri, i biri i Isufit, i dt. 1962, banues ne lagjen " 30 -vje-
-tori" Berat, me 2 pasaporte Nr: 068121, 2. Bari Paja, i biri i Refatit, i dt. 1954, banues ne lagjen " Jani Vruho " Berat, me pasaporte (certifikate nr: 12/32, 3. Tefik Syri, i biri i Isufit, i dt. 1967, banues ne lagjen " Jani Vruho " te Beratit, me certifikat me Nr: 4/41 , 4. Valbona Syri, e bija e Shuaipit, e dt. 19.1.1982, banues ne lagjen " Clirimi " Berat, me certifikate nr: 20/10, Te lartepmendurit , me shtet te plote juridike për te vepruar, me deshiren dhe me vullnetin e tyre te lire nenshkruan ne prezencen time statutin e mesipërme. Une noterja e vertetoj rregullisht.



N O T E R E

(Natasha Dervishi)

[Handwritten signature of Natasha Dervishi]

100
LEKE
RISHQIPËRISË